

VENDIM
Nr.974, datë 30.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËTORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË MEMALIAJ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 45 (dyzet e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 263 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Memaliaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
11-13	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
14,15,16	Varrezat publike	Në pronësi
17,19,47,68-114,116-124,204-241	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
18,20-45,48-67,115,125	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në pronësi
126,127-141	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
147	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
175-179,181-183,185-198	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
46,180,184	Toka bujqësore jo produktive	Në pronësi
149-151,155	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit	Në pronësi

	ekonomik.	
199,200	Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza	Në pronësi